



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2023

VENDIM

Nr. 338, datë 27.06.2023

**PËR
TRANSFERIMIN E PËRHERSHËM TË KANCELARIT TË GJYKATËS
ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË VLORË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, nenit 80, nenit 83 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin nr.557, date 29.12.2022 të KLGJ-së “Për krijimin, kompetencat dhe funksionimin e Komisioneve të Ristrukturimit”, ndryshuar me Vendimin nr. 285, datë, 29.05.2023, Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 299, datë 30.05.2023 “Mbi miratimin e rregullave standarde, për organigramën, përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësi të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”, Vendimit të KLGJ-së nr. 304, date 05.06.2023 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Vlorë”,

VENDOSI:

1. Znj. {...}, transferohet në mënyrë të përhershme në pozicionin Kancelar, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 01.07.2023.
3. Njoftimin e këtij vendimi zj. {...} dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR